



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 70, Datë 12.03.2021

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL” SH.A., PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 213, SERIA PM13P, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 132, DATË 06.12.2011, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S DHE TRANSFERUAR ME VENDIMIN NR. 126, DATË 28.10.2013, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S TEK SHOQËRIA “KURUM INTERNATIONAL” SH.A. PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-I “ULËZ” ME KAPACITET TË INSTALUAR 24 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 10, pika 3 dhe nenit 15, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 19, pika 1, gërma “a” dhe nenit 15, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE - s, në mbledhjen e tij të datës 12.03.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 35/5 prot., datë 11.03.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a,

Konstatoi se:

- Shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a, me shkresën nr. 427 prot., datë 05.03.2021, ka përcjellë në ERE kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike për HEC Ulëz.
- Kërkesa për modifikim, vjen për arsye se gjatë rehabilitimit të këtij HEC-i në lidhje me optimizimin e operimit të turbinave, janë zëvendësuar me pajisje te reja disa pajisje kryesore të HEC-it, çka ka sjellë edhe rritjen e kapacitetit të tij me 6 MW.
- Licencat e dhëna nga ERE me vendimin nr. 132/2011 “Për licencimin e shoqërisë “HEC ULËZ – SHKOPET” sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et Ulëz dhe Shkopet”, dhe me vendimin nr. 136/2011, “Për licencimin e shoqërisë “HEC Bistrica 1 dhe Bistrica 2” sh.a. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC Bistrica 1 dhe Bistrica

2”, janë transferuar tek shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 126, datë 28.10.2013, me nr. 213, Seria PM13P.

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., në bazë të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, rezulton i plotësuar si më poshtë:

Në zbatim të nenit 7, “**Delegimi i të drejtave të aplikuesit**”, pika 2, germa “a”, do t’i kërkohet shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., të depozitojë në ERE autorizimin për përfaqësuesin ligjor të saj.

Formati dhe dokumentacioni për aplikim;

- Neni 9, pika 1, gjerat “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin) **Plotësuar;**
- Neni 15, pika 4:
- germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës; **Plotësuar.**
- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. **Nuk aplikohet për këtë rast, pasi HEC Ulëz është HEC privat.**
- germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE. **Plotësuar.**

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me nenin 15, pika 4,

- germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës; **Pa plotësuar.**
- germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi; **Pa plotësuar**, do të njoftohet subjekti që t’i paraqesë ato brenda afateve që përcakton “*Rregullorja për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”,
- Po ashtu në kuptim të nenit 11, pika 1, të rregullores së licencimit, shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a, do t’i kërkohet edhe informacion rreth vlefshmërisë së “*Marrëveshjes për lidhje të re*”, që ka nënshkruar me OST sh.a., në kuadër të ndryshimeve të karakteristikave të HEC-eve, të cilat prekin kapacitetin total të instaluar dhe Vlefshmërinë e Lejes Mjedisore që disponon.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me nr. 213, Seria PM13P, miratuar me vendimin nr. 132, datë 06.12.2011 të bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe transferuar me vendimin nr. 126, datë 28.10.2013, të bordit të Komisionerëve të ERE-s tek shoqëria “KURUM

INTERNATIONAL” sh.a. për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-i “Ulëz” me kapacitet të instaluar 24 MW, si me poshte:

Ishte: kapaciteti i instaluar 24 kW

Behet: kapaciteti i instaluar 31 kW

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI